



VENDIM

Nr.61 Datë 19.08.2009

**PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË
“PURO ENERGY STEBLEVA” SH.P.K NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 “a”, neni 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, neni 18 pika “1” gërma “d” të Ligjit 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”, dhe 13, 14 të “Rregullores për Procedurat e Licensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshem dhe Rinovimit të Licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 19.08.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “PURO ENERGY STEBLEVA” sh.p.k., për t`u licensuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

Dhe konstatoi:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s lidhur me licensimet në sektorin e energjisë elektrike të

- **Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1)**
- **Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronesor (neni 9, pika 2)**
- **Dokumentacionin finciar dhe fiskal (neni 9, pika 3)**
- **Dokumentacionin teknik (neni 9, pika 4)**
- **Lejet nga institucione te tjera (leja mjedisore dhe leja e përdorimit te ujit) (neni 9, pika 4.1.5, germa b dhe c)**

Mungesa e Dokumentacionit që ka të bëjë me:

- **Plotësimin në mënyrë te pjesshme të lidhjes me sistemin elektroenergjetik (neni 9, pika 4.1.5, germa a), pasi për arsye të privatizimit dhe riorganizimit të Shoqërisë OSSH sh.a, aplikuesi nuk ka**

mundur te paraqese një dokument final nga OSSH sh.a. (është paraqitur vetëm nga Drejtoria rajonale TL Elbasan).

Vendosi:

1. Licensimin e shoqërisë “PURO ENERGY STEBLEVA” shpk ne aktivitetin e prodhimit te energjise elektrike nga HEC Stebleva me fuqi 3.4 MW me kusht qe te paraqese dokumentin e miratimit te pikes se lidhjes me sistemin elektroenergjetik para fillimit te operimit te HEC Stebleva.
2. Afati i vlefshmerise se licenses te jete 30 vjet.
3. “PURO ENERGY STEBLEVA” shpk të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Stebleva sipas afatit te përcaktuar në marrëveshjen e koncesionit.
4. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr.61 Datë 19.08.2009

PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË
“PURO ENERGY STEBLEVA” SH.P.K NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkelqim Bozgo	_____	_____